

VENDIM
Nr.477, datë 23.6.2005

**PËR SHPËRBLIMIN E USHTARAKËVE, PJESEMARRËS NË OPERACIONIN “ALTHEA”
TË BASHKIMIT EUROPIAN, NË BOSNJË-HERCEGOVINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.9315, datë 11.11.2004 “Për dërgimin e kompanisë paqeruajtëse shqiptare për të marrë pjesë në operacionin e Bashkimit European “ALTHEA” në Bosnjë-Hercegovinë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ushtarakët, që marrin pjesë në operacionin e Bashkimit European “ALTHEA” në Bosnjë-Hercegovinë, për ditët e qëndrimit atje, veç pagës mujore, të marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, në masën 15 (pesëmbëdhjetë) euro.

2. Personeli, civil dhe ushtarak, që do të inspektojë këto trupa, për ditët e qëndrimit atje, të marrë dyfishin e shpërblimit ditor, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Personeli, civil dhe ushtarak, që është pjesë e shtabit të operacionit të Bashkimit European “ALTHEA” në Bosnjë-Hercegovinë, përveç pagës mujore, të marrë, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, në masën 15 (pesëmbëdhjetë) euro.

Shpenzimet administrative për këtë personel të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, kundrejt faturave përkatëse.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Vendimi nr.764, datë 29.7.1996 i Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e ushtarakëve që marrin pjesë në operacionin e NATO-s “Përprjekja e përbashkët”, në ish-Republikën Jugosllave”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano